



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 1433 prot.

Pukë, më 20.08.2025

PROJEKT VENDIM

Nr. 07, datë 20.08.2025

PËR

SHTYRJEN E AFATIT TË ZBATIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT TË BASHKISË PUKË
2022–2025 ME NJË VIT SHITESË

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, ligji nr. 9131/2003 ‘Për rregullat e etikës në administratën publike’, VKM nr.516, datë 01.07.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr.247 datë 20.03.2015 ‘Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale e kundër korrupsionit për periudhën 2015-2020 dhe miratimin e planit të veprimit 2020-2023 në zbatim të strategjisë ndërsektoriale kundër korrupsionit 2015-2023 e të pasaportës së indikatorëve”, VKB nr.33, datë 03.08.2022 ‘Për Miratimin e Planit të Integritetit të Bashkisë Pukë 2022-2025’, Këshilli i Bashkisë Pukë, me propozim të kryetarit të Bashkisë:

VENDOSI:

1. Të shtyhet me një vit tjetër afati i zbatimit të Planit të Integritetit të Bashkisë Pukë, nga viti 2025 deri në Gusht 2026.
2. **Zgjatja e afatit vjen si nevojë për të mundësuar:**
 - Përfundimin e disa masave të papërfunduara në planin aktual;
 - Përforcimin e mekanizmave të parandalimit të korrupsionit dhe rritjen e transparencës institucionale;
 - Përgatitjen e një procesi gjithëpërfshirës dhe cilësor për hartimin e Planit të ri 2026–2030.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Bashkisë Pukë dhe Koordinatori i Integritetit për ndjekjen dhe raportimin e vazhdueshëm të zbatimit të këtij plani në periudhën e shtyrë.
4. Ky vendim hy në fuqi 10 ditë pas shpalljes, sipas ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 55, pika 6.


Paraqitën projektin;

Drejtori i Menaxhimit të BNJ.

Sokol Gjoni

Juristi

Aida Sinani





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 1433/prot.

Pukë, më 20.08. 2025

RELACION SHPJEGUES

Lidhur me projekt-vendimin “Për shtyrjen e afatit të Planit të Integritetit të Bashkisë Pukë 2022–2025 me një vit tjetër”

Të nderuar anëtarë të Këshillit të Bashkisë,

Ky relacion ka për qëllim të parashtrojë arsyetimin për shtyrjen e afatit të zbatimit të Planit të Integritetit të Bashkisë Pukë 2022–2025 dhe me një vit tjetër, deri në Gusht 2026.

Plani i Integritetit është një dokument strategjik me rëndësi të veçantë për garantimin e standardeve të etikës, transparencës dhe luftës kundër korrupsionit në administratën publike vendore. Zbatimi i tij është një ndër angazhimet kryesore institucionale për përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve dhe forcimin e besimit publik.

Gjatë periudhës 2022–2025 janë realizuar një sërë masash konkrete në përputhje me planin, por disa veprime të rëndësishme kërkojnë më shumë kohë për përmbushje, përfshirë:

- Konsolidimin e mekanizmave të brendshëm të kontrollit dhe auditimit;
- Përmirësimin e etikës dhe procedurave në shërbimin civil;
- Implementimin e teknologjive për transparencë dhe rritjen e integritetit.

Shtyrja me një vit e këtij afati do të mundësojë finalizimin e masave të mbetura, vlerësimin e plotë të impaktit të deritanishëm dhe përgatitjen cilësore të Planit të ri të Integritetit për periudhën 2027–2030.

Kjo shtyrje përbën një veprim institucional të përgjegjshëm, në funksion të konsolidimit të etikës publike dhe përmbushjes së standardeve që kërkon shërbimi ndaj qytetarëve.

Ju ftojme të miratoni projekt-vendimin në fjalë.

Përgatiti relacionin

DREJTORI I DREJTORISË SË MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

SOKOL GJONI